REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

**ADMINISTRATORI**

Nr. 1008/2 Prot.　　　　　　　　　　Tiranë, më 10. 06 2026

**NJOFTIM**

**PËR DONATORË PËR HARTIM PROJEKTI PËR RIKONSTRUKSIONIN E HYRJES KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Universiteti i Sporteve të Tiranës në kuadër të përmërsimit të infrastrukturës dhe krijimit të të kushteve bashkohore për studentët dhe aktivitetet sportive, shpall thirrjen për donatorë (Arktitektë/zyra projektimi) për hartimin e projektit Teknik për Rikonstruksionin e hyrjes së saj. Kjo thirrje synon përzgjedhjen e një subjekti (individ ose studio projektimi), që të kontribojë në formë dhurimi për hartimin e projektit të plotë Teknik, pa kundërshpërblim financiarë nga Universiteti.

Përmbajtja e projektit

Projekti duhet të përfshijë, në mënyrë të detajuar:

1. Projekt arkitektonik dhe konstruktiv të hyrjes kryesore;
2. Relacion dhe specifikimet teknike;
3. Sistemin e ndriçimit, traut dhe vendrojes së hyrjes;
4. Deklaratë e përgjegjësisë profesionale;
5. Policën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale;
6. Preventivin;
7. Grafikun e punimeve.

Kriteret për pjesëmarrje

Të interesuarit duhet të plotësojnë këto kritere:

- Të jenë arkitektë/zyra projektimi të licencuara;
- Të kenë eksperiencë në projekte të ngjashme;
- Të shprehin gatishmëri për realizimin e projektit në formë dhurimi;
- Të respektojnë standardet teknike dhe legjislacionin në fuqi.

Dokumentacioni i kërkuar

Subjektet e interesuara duhet të paraqesin:

a) Letër shprehje interesi;
b) CV/portofol pune;
c) Kopje e licencës profesionale.

Afati i aplikimit
Afati për paraqitjen e interesit është deri më: 16 / 06 / 2026.

Mënyra e aplikimit
Aplikimet dorëzohen: në zyrën e Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës,

**ADMINISTRATORI**

**Haxhirete Sulaj**